



Kosova dhuron

2020

RAPORTI VJETOR MBI GJENDJEN E FILANTROPISË



Përmbajtja

Pasqyrë e përgjithshme	1
Donatorët	6
Temat	13
Pranuesit	16
· Organizatat jofitimprurëse si pranues	20
· Shteti si Pranues	25
Përfituesit përfundimtarë	29
Efektet e dhurimit	35
Përfshirja mediatike e dhurimit	39
Përmbledhje e metodologjisë	41
Shtojcë – Trende krahasuese të dhurimit që nuk ka të bëjë me Kovid-19	42

Pasqyrë e përgjithshme

Përhapja e Kovid-19 pati një ndikim të paprecedentë në filantropinë në Kosovë ashtu siç kishte në mbarë botën. Për të kuptuar se çfarë ndryshoi gjatë pandemisë, ne përshtatëm metodologjinë tonë dhe mbledhëm veçmas të dhëna për dhurimin që ka të bëjë dhe që nuk ka të bëjë me Kovid-19. Ky raport mbi gjendjen e filantropisë në Kosovë gjatë vitit 2020 është specifik sepse nuk fokusohemi në trendet. Në vend të krahasimit me vitet e mëparshme që mund të jetë çorientues për shkak të pandemisë, ne fokusohemi vetëm në përshkrimin dhe analizën e dhurimit në këto rrethana të jashtëzakonshme. Në të njëjtën kohë, ne kemi përgatitur një shtojcë me krahasime midis dhurimit që nuk ka të bëjë me Kovid-19 në vitin 2020 dhe dhurimit në vitet e mëparshme, në mënyrë që lexuesi të plotësojë nevojat e veta specifike të të dhënave.

Filantropia në Kosovë ka përjetuar sfida të mëdha dy vite radhazi. Në vitin 2019 ndodhi një tërmet në Shqipëri dhe në vitin 2020 u paraqit pandemia e Kovid-19. Duket se pandemia inkurajoi donatorët të ofrojnë shumë më shumë donacione. Shuma e regjistruar ishte 3.2 herë më e madhe dhe rastet e dhurimit ishin pothuajse 2.5 herë më të shpeshta se një vit më parë. Një pjesë e madhe e donacioneve me vlerë të lartë, të tilla si pajisje të shtrenjta dhe pako të konsiderueshme shëndetësore dhe ushqimore, rritën ndjeshëm shumën e dhuruar për banor - nga 1.5 në 8.1 euro. Duke pasur parasysh të dhënat në dispozicion, ne kemi llogaritur se vlera e parashikuar e donacioneve është pothuajse dy herë më e madhe se shuma e regjistruar.



14,517,332.2 €

Vlera e llogaritur
e donacioneve



7,702,340.4 €

Shuma e regjistruar



554

Numri i rasteve
të regjistruara



8.1 €


Shuma e dhuruar
për banor

Në vitin 2020, më shumë se 1.9 milionë euro dhe gati gjysma e të gjitha rasteve, u dhuruan për lehtësimin dhe shërimin nga Kovid-19. Nga perspektiva rajonale, Kosova kishte një strukturë unike të dhurimit. Përderisa në Kosovë dhurimi që nuk kishte të bëjë me Kovid-19 ishte gati 2.9 herë më i madh se sa mbështetja në lidhje me Kovid-19, donacionet në lidhje me pandeminë në vendet e tjera ishin më të mëdha se dhurimi që nuk kishte të bëjë me Kovid-19. Në Kosovë, donatorët vendosën të caktojnë pothuajse dy të tretat e shumës së dhuruar për trajtime mjekësore që nuk kanë lidhje me pandeminë, arsimin, lehtësimin e varfërisë dhe mbështetjen për grupet e marginalizuara.

Numri i rasteve të dhurimit



Shumat e regjistruara



Një trend i pandërprerë nga vitet e kaluara është se pothuajse një e treta e të gjitha rasteve të dhurimit dhe më shumë se gjysma e vlerës së dhuruar ka ardhur nga diaspora. Tre të katërtat e asaj shume nuk kishin të bëjnë me pandeminë, duke u orientuar për trajtime mjekësore, arsim, lehtësimin e varfërisë dhe mbështetje për grupet e marginalizuara. Sa i përket llojeve të donatorëve, sektori i korporatave dhe fondacionet private kanë pasur pjesëmarrje dukshëm më të lartë në vitin 2020. Sektori i korporatave - kryesisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme - e zmadhuan pjesëmarrjen e tyre me më shumë se dyfishi i shumës së tyre në totalin e rasteve të dhurimit dhe shumën totale të dhuruar. Pjesa më e madhe u dhurua si përgjigje ndaj Kovid-19 (86.0% e vlerës), ndërsa donacionet që nuk kishin të bëjnë me pandeminë shkuan drejt kujdesit shëndetësor, lehtësimit të varfërisë dhe arsimit. Fondacionet private morën pjesë me 18.0% të shumës totale, në krahasim me vetëm 6.4% në vitin 2019. Kjo rritje është edhe më e dukshme, duke pasur parasysh rritjen e dhurimit në përgjithësi.

Qeveria pati një rol të madh në luftën kundër pandemisë, duke vepruar si ndërmjetëse mes donatorëve dhe përfituesve. Nga të gjitha rastet e dhurimit që kanë të bëjnë me Kovid-19, pothuajse gjysmat iu drejtuan qeverive lokale dhe kombëtare. Vetëm 17.8% e rasteve që përfshijnë 2.6% të shumave që kanë të bëjnë me Kovid-19 iu dhuruan drejtpërdrejt institucioneve. Organizatat jofitimprurëse kishin një pjesë relativisht të lartë të donacioneve nga aksionet e lidhura me pandeminë: rreth një të katërtën e shumës së dhuruar. Pjesa më e madhe e saj u mbledh përmes fushatave për mbledhjen e fondeve për shpërndarjen e maskave respiratore, pajisjeve mbrojtëse dhe mburojave të fytyrës. Është e rëndësishme të theksohet se shumica e donacioneve janë ndihmuar nga një numër relativisht i vogël i organizatave të mëdha dhe fondacioneve private. Krahasuar me vitin 2019, shumica e përgjithshme e dhuruar e drejtuar kah organizatat jofitimprurëse pothuajse u dyfishua.


Ashtu si një vit më parë, një pjesë e madhe e donacioneve shkuan drejtpërdrejt për individë dhe familje. Më shumë se një e treta e shumës së dhuruar për lehtësimin e pasojave nga Kovid-19 iu drejtua individëve dhe familjeve, në kundërshtim me pritshmërinë që shumica e donacioneve do t'i jepeshin shtetit. Pavarësisht dhurimit të lartë për lehtësimin e pasojave nga Kovid-19, me qëllim të mbështetjes së arsimit u dhuruan më shumë se 1 milion euro, që ishte më shumë se gjysma e shumës totale të regjistruar për të gjitha temat në vitin 2019. Sa i përket efekteve të dhurimit, më shumë se dy të tretat e rasteve të dhurimit ishin mbështetje të njëhershme. Kur krahasojmë shumat e dhuruara, dhurimi strategjik përbëhej nga një pjesë pak më e madhe se dhurimi i njëhershëm, për shkak të donacioneve për pajisje të vlefshme, investimeve në infrastrukturën publike dhe shumave të mëdha për bursa. Pothuajse të gjitha dhurimet që nuk kishin të bëjnë me Kovid-19 ishin në formë të parave, ndërsa rreth një e katërta e dhurimit që kishte të bëjë me pandeminë ishte në formën e mallrave ose materialeve të konsumit. Duke marrë parasysh mënyrat e dhurimit, 98.2% e shumës së dhuruar për Kovid-19 dhe 82.7% e fondeve për qëllime që nuk kanë të bëjnë me pandeminë janë mbledhur përmes fushatave për mbledhjen e fondeve.


Siç pritej, pjesa më e madhe e donacioneve shkoi në rajonin e Prishtinës (pak më pak se një e treta e të gjitha rasteve të dhurimit), ndërsa rajonet e tjera si Prizreni, Mitrovica, Gjlani dhe Gjakova kishin një pjesëmarrje deri në 14% secila. Dhurimi si ai që kishte të bëjë edhe ai që nuk kishte të bëjë me Kovid-19 ishte pothuajse i balancuar në shumicën e komuniteteve. Donacionet në nivel kombëtar, të destinuara për përfituesit në të gjithë vendin, kishin pjesëmarrjen e tyre prej 9.4% të rasteve dhe kishin një raport të balancuar donacionesh që kanë dhe që nuk kanë të bëjnë me Kovid-19. Së fundi, përkundër nevojës për ndihmë në Kosovë, komuniteti filantropik ka ofruar 2.7% të mbështetjes jashtë vendit.

Map - Përqindja e rasteve të dhurimit për rajonet



Dhurimi i Përgjithshëm





Donatorët


Në vitin 2020 kemi regjistruar 7.7 milionë euro donacione, që është gati tre herë më e lartë se shuma e dhuruar në vitin e kaluar. Individët e caktuar ishin, përsëri, donatorët më aktivë, ndërsa pjesa më e madhe e shumës u gjenerua nga donacionet e shumicës individuale. Konkretisht, individë të caktuar morën pjesë në 37.2% të të gjitha rasteve të dhurimit. Aksionet nga individët ishin më shumë të fokusuara në qëllime që nuk kishin të bëjnë me Kovid-19, nga të cilët përqindja më e madhe ishte për arsimin. Krahasuar me një vit më parë, individët kanë pësuar një rënie të lehtë të pjesëmarrjes në rastet e dhurimit. Nëpërmjet thirrjeve të ndryshme dhe fushatave për mbledhjen e fondeve, qytetarët dhuruan sasinë më të madhe nga të gjithë kategoritë e donatorëve (41.5% e shumës së dhuruar). Rreth gjysma e kësaj shume kishte për qëllim kujdesin shëndetësor që nuk kishte të bëjë me lehtësimin e pasojave nga Kovid-19.

Spektori i korporatave mori pjesë në më shumë se një të katërtën e të gjitha rasteve të dhurimit. Është e rëndësishme të theksohet se një përqindje e madhe e mbështetjes së korporatave në Kosovë erdhi nga kompanitë e vogla dhe të mesme, të cilat ishin veçanërisht të rrezikuara gjatë pandemisë, jo nga korporatat e mëdha ndërkombëtare apo kombëtare. Kjo është e pazakontë në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Shumica e dhurimeve të spektorit të korporatave u drejtuan si përgjigje ndaj Kovid-19 (86% e vlerës) ndërsa dhurimet që nuk kishin të bëjnë me pandeminë shkuan drejt kujdesit shëndetësor, lehtësimit të varfërisë dhe arsimit. Krahasuar me një vit më parë, sektori i korporatave ka dhuruar një shumë tetë herë më të lartë – që është ndryshimi më i madh nga të gjitha kategoritë e donatorëve që ka ndodhur në vitin 2020.



Fondacionet private kanë dhuruar 7.2% të të gjitha rasteve të dhurimit dhe 18.0% të shumës. Kjo paraqet një rritje krahasuar me një vit më parë (0.9% raste të dhurimit dhe 6.4% e shumës). Sqarimi për këtë rritje mund të jepet duke parë disa fushata të suksesshme që inkurajuan dhurimin e mjeteve mbrojtëse mjekësore për institucionet; të mira ushqimore dhe higjienike për njerëzit në nevojë; dhe mjete arsimore dhe bursa. Është e rëndësishme të theksohet se Fondacioni Biberaj ka dhuruar pjesën më të madhe të shumës së regjistruar të dhuruar nga fondacionet private, që do të thotë se nuk kemi vërejtur rritje të ndjeshme të pjesëmarrjes nga fondacione të tjera private.

Rreth një e treta e të gjitha rasteve të dhurimit dhe më shumë se gjysma e shumës së dhuruar është dhuruar nga diaspora. Pjesa më e madhe e saj (83.9% e vlerës) nuk lidhej drejtpërdrejt me pandeminë, por përkundrazi me kujdesin shëndetësor, lehtësimin e varfërisë dhe arsimin, duke përfshirë pajisjet dhe bursat. Diaspora ka marrë pjesë në pothuajse 80% të vlerës së dhuruar për pushtetin lokal, më shumë se 80% të vlerës së dhuruar për institucionet dhe më shumë se gjysmën e vlerës së dhuruar për individët dhe familjet.



Rastet e dhurimit (%)





Dhurimi i përgjithshëm





Shumat (%)





Dhurimi i përgjithshëm



Rastet e dhurimit (%)



Shumat (%)



Fondacioni BONEVET Prishtinë mbledhi fonde për pajisje mbrojtëse për punonjësit e kujdesit shëndetësor

Fondacioni BONEVET Prishtinë organizoi fushatën për mbledhjen e fondeve “Bashkëngjitju luftës” me qëllim të blerjes së 43 printerëve të rinj 3-D për prodhimin e maskave mbrojtëse të fytyrës për punonjësit mjekësorë. Fushata përfundoi më 29 maj të vitit 2020 dhe rezultoi me 66,000 euro të mbledhura përmes platformës Kosovaldeas. Janë prodhuar gjithsej 8,500 maska 3-D, dhe 7,100 janë dhuruar për punonjësit shëndetësorë dhe administrativë, si dhe të tjerë në nevojë për të parandaluar përhapjen e Covid-19.

Vreshtaria dhe Verëtaria Stone Castle dhuroi ushqime dhe produkte sanitare

Kompania **Stone Castle Vineyards and Winery** i dhuroi komunës së Deçanit ushqime dhe produkte sanitare në vlerë prej 10,000 euro, të cilat u parapanë t'u shpërndahen 400 familjeve. Donacioni është bërë me mbështetjen e fondacionit humanitar “Rrustem Gecaj”. Vreshtaria dhe Verëtaria Stone Castle gjithashtu i dhuroi Ministrisë së Shëndetësisë 10,000 litra alkool etilik, i cili do të përdorej si dezinfektues, i dedikuar për institucionet shëndetësore në mbarë Kosovën.

Donator nga Gjermania dhuroi respiratorë për institucionet shëndetësore

Ahmet Hoti, nga Gjakova, i cili jeton dhe punon në Kanada, ka dhuruar katër respiratorë për Spitalin e Gjakovës si ndihmë gjatë pandemisë. Ahmeti i ka dhuruar edhe një aparat respirator për Klinikën Infektive, i cili është dorëzuar më 10 Prill të vitit 2020, nga stafi i Kallxo.com.

Shoqata nga Diaspora Fehmi Agani ka dhuruar pajisje ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara

Në ditën ndërkombëtare të përdoruesve të karrocave për invalidë (1 Mars të vitit 2020), përfaqësuesit e **HANDIKOS** dhe **Handicap Kosova** dhe Komuna e Prishtinës shpërndanë mbi 500 pajisje ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara. Pajisjet ishin donacion nga **shoqata e diasporës Fehmi Agani** nga Arendali i Norvegjisë, dhe të cilat kapin vlerën prej mbi 400,000 euro. HANDIKOS dhe Handicap Kosova vazhduan këtë projekt humanitar edhe në komunat tjera anembanë Kosovës.


Temat

Paraqitja e Kovid-19 si një temë e re rezultoi në një raport dukshëm të ndryshëm për dhurimin. Për shkak të mbështetjes së ridrejtuar të donatorëve për lehtësimin e pandemisë, ne kemi ndarë dhurimin në lidhje me këtë qëllim dhe e kemi paraqitur atë si një temë të pavarur. Rreth gjysma e të gjitha rasteve të dhurimit dhe pak më pak se një e treta e shumës së dhuruar u drejtua për lehtësimin dhe shërimin nga Kovid-19. Si rezultat, katër temat kryesore të zakonshme për dhurim – arsimi, lehtësimi i varfërisë, kujdesi shëndetësor dhe mbështetja për grupet e marginalizuara pësuan një ulje të përqindjes së rasteve të dhurimit. Donacionet që më parë regjistroheshin për shëndetësinë dhe arsimin tani regjistroheshin për Kovid-19 nëse qëllimi i aksionit ishte zbutja e efekteve negative të pandemisë.

Në vitin e pandemisë, 11.6% e rasteve të dhurimit janë dedikuar për arsimin. Fondacionet private dhe diaspora vazhduan të investojnë në bursa, pajisje arsimore dhe avancimin teknologjik të mjeteve mësimore. Pavarësisht sfidave të pandemisë, pjesa e shumës së dhuruar për arsimin u rrit në krahasim me vitin 2019 (17.2% në vitin 2020 kundrejt 0.9% në vitin 2019).

Shëndetësia mori pjesë me pak më pak se një të katërtën e shumës së dhuruar, pavarësisht nga pjesëmarrja prej vetëm 7.8% në të gjitha rastet e dhurimit. Një raport i lartë shkaktohet nga investimet e vlefshme kapitale dhe pajisjet mjekësore. Përveç temave kryesore për dhurim, donatorët më shpesh e drejtuan mbështetjen e tyre për qëllime të dhurimit sezonal (7.8%). Është e rëndësishme të theksohet se pjesëmarrja në shumën e dhuruar për dhurimin sezonal është rritur krahasuar me një vit më parë (1.4% në vitin 2020 kundrejt 0.1% në vitin 2019), që ka ardhur si rezultat i donacioneve të shumta në formën e pakove ushqimore për familjet me status të pa favorshëm në shoqëri.

Temat kyçe – Rastet e dhurimit (%)



Temat tjera – Rastet e dhurimit (%)

7.8%	Dhurimi sezonal
1.3%	Kulturë dhe art
0–1%	Infrastruktura publike, aktivitete religjioze, mjedisi, sport, trashëgimi, zhvillim ekonomik

Fondacioni Biberaj Inc. ndau bursa për studentët

Fondacioni Biberaj Inc., me seli në SHBA, ka ndarë bursa akademike për 40 studentë që studiojnë në Rochester Institute of Technology Kosovë. Bursat janë pjesë e Çmimit të Bursave Familjare Biberaj, i cili zgjat katër vjet dhe jepet me konkurs për studentët me arritje të larta akademike që kanë nevojë për ndihmë financiare. Bursa e Familjes Biberaj vë theksin në fuqizimin e grave në akademi; prandaj, fondacioni ndau deri në 75 për qind të bursave të tij për studentet femra. Bursat u jepnin përparësi studentëve që studionin shkencë, inxhinieri, teknologji, matematikë dhe/ose gazetari. Siç e kemi regjistruar, vlera e bursave të dhuruara ka qenë rreth 1,000,000 euro, ndërsa fondacioni ka deklaruar se janë ndarë 36 bursa për studentë shqiptarë nga Tropoja, Plava, Gucia, Presheva, Tetova, Shkupi dhe pjesët rurale të Kosovës, ndërsa katër bursa janë ndarë për studentët nga grupet e pakicave kombëtare në Kosovë.

Kosova Makers League dhe Fondacioni BONEVET Prishtinë: Qytetarët Digjital 2.0

Kosova Makers League dhe **Fondacioni BONEVET Prishtinë** pajisën me mjete edukative dhjetë biblioteka publike në Gjiilan, Prizren, Viti, Ferizaj, Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Shtime dhe Skënderaj. Projekti synonte të transformonte bibliotekat publike në qendra për zhvillimin e aftësive digjitale duke dhuruar pajisje Microbit, printera 3-D, laptopë dhe teknologji të tjera. Qëllimi i këtyre donacioneve ishte që qytetarët të mësojnë të punojnë me pajisje të avancuara teknologjike. Fondacioni BONEVET Prishtinë ka ofruar edhe punëtori edukative për bibliotekarët dhe qytetarët. Projekti u organizua nga Instituti për Rini, Zhvillim dhe Inovacionin (IRIM) me mbështetjen e Google.

Devolli dhe Elkos shpërndanë pako ushqimore

Devolli Corporation, **Devolli Group** dhe **Elkos Group** iniciuan një fushatë për shpërndarjen e pakove ushqimore për familjet në nevojë në Kosovë gjatë pandemisë. Pakot e dhuruara përmbanin 300 tonë miell “Finesa”, 33 pako qumështi “Vita” dhe 33 pako me lëngje “Tango” të cilat, siç e kemi regjistruar, kapin vlerën e rreth 500,000 euro. Korporatat gjithashtu dhuruan ndihma në Selinë Komunale për Menaxhimin e Situatës gjatë Covid-19.

Kompania Coca-Cola Hellenic Bottling Kosova dhe Kryqi i Kuq i Kosovës mbështetën familjet në nevojë

Një shembull tjetër që bie në sy këtë vit është kontributi financiar i **Coca-Cola Hellenic Bottling Company Kosova**. Siç kemi regjistruar, kompania ka dhuruar rreth 45,437 euro për Kryqin e Kuq të Kosovës me qëllim që të mbështesë 830 familje me pako ushqimore dhe higjienike gjatë pandemisë. Kompania Coca-Cola Hellenic Bottling Kosovo ka mbështetur përpjekjet e Kryqit të Kuq të Kosovës që nga fillimi i pandemisë. Deri më tani ata kanë dhuruar 43,000 litra nga produktet e tyre për punonjësit e mjekësisë, vullnetarët dhe qytetarët në kushte të vështira ekonomike.

Fondacioni Labinot Tahiri ofroi ndihma për familjet në nevojë

Fondacioni Labinot Tahiri ka iniciuar një fushatë për mbështetjen e familjeve me asistencë sociale gjatë pandemisë. Mjetet janë mbledhur në emisionin në KTV, me Labinot Gashin dhe pas vetëm një ore e gjysmë janë mbledhur 103,000 euro. Shuma totale e dhuruar për fushatën ishte 200,000 euro të cilat ishin të destinuara për mbështetjen e 25,000 familjeve. Në këtë fushatë kanë kontribuar edhe këngëtarët **Loreta Kaçka** dhe **Sinan Hoxha** me donacione në vlerë prej 1000 euro secili. Gjatë pandemisë, Fondacioni Labinot Tahiri ka ndihmuar 30 komuna të Kosovës duke dhuruar pako ushqimore.

Një filantrop nga diaspora përkrahu Shoqatën Down Syndrome Kosova

Arti Qelaj, një sipërmarrës që jeton dhe punon në Zvicër, i dhuroi 7,000 euro Shoqatës Down Syndrome Kosova për mbështetjen e shërbimeve të ofruara nga programet e tyre: Programi për Intervenim dhe Edukim të Hershëm dhe Programi për Autonomi dhe Aftësim Profesional. Shoqata Down Syndrome Kosova ofron shërbime terapeutike profesionale falas në Prishtinë, Prizren, Mitrovicë dhe Ferizaj. Duke qenë se zhvillimi dhe mirëmbajtja e terapive janë shumë sfiduese për këtë organizatë, fondet e dhuruara ishin shumë të nevojshme dhe mbuluan një pjesë të shërbimeve terapeutike që u ofrohen rreth 200 anëtarëve të organizatës.

Kompania Maqani kontribuoi për familjet me status të pa favorshëm social

Kompania e distribuimit **Maqani**, Prishtinë, dhuroi 12,500 euro për fushatën tradicionale humanitare “Sofra e Ramazanit”. Mjetet e dhuruara ishin të destinuara për sigurimin e 500 pakove ushqimore në qytetin e Prishtinës, për t’u shpërndarë tek familjet me status të pa favorshëm social. Fushata u organizua nga Shoqata Humanitare Bereqeti dhe ishte aktive nga 11 Prill 2020 deri më 1 Maj 2020.

Pranuesit



Përfituesit më të mbështetur në vitin 2020, si në shpeshhtësinë e dhurimit ashtu edhe në vlerën e regjistruar, ishin individët dhe familjet. Më konkretisht, 37.4% e shumës së përgjithshme, nëpërmjet 43.1% të të gjitha aksioneve, iu dhurua drejtpërdrejt këtyre përfituesve. Nga të gjitha donacionet për individët dhe familjet, më shumë se dy të tretat ishin për qëllime që nuk kishin të bëjnë me pandeminë, më së shpeshti për mbështetjen e arsimit.

Shteti (institucionet dhe qeveritë lokale/kombëtare) pranoi më shumë se një të tretën e shumës totale të dhuruar. Pjesa më e madhe e dhurimit ndaj shtetit iu dedikua qeverive lokale dhe kombëtare dhe institucioneve shëndetësore. Sa i përket vetëm dhurimit për Kovid-19, shteti ishte ndërmjetësi kryesor – me më shumë se një të tretën e shumës dhe me pak më pak se dy të tretat e të gjitha rasteve të dhurimit që kanë të bëjnë me Kovid-19.



Donatorët drejtuan 12.6% të rasteve të dhurimit dhe 24.0% të shumës totale drejt organizatave jofitimprurëse. Sektori jofitimprurës u përqendrua më shumë në tema të tjera që nuk kanë të bëjnë me pandeminë, gjë që pritet kur merret parasysh se është aktori kryesor në mbështetjen e grupeve të marginalizuara. Më saktësisht, pak më pak se dy të tretat e shumës së dhuruar, të dhuruar për sektorin jofitimprurës ishte për qëllime që nuk kishin të bëjnë me Kovid-19. Sektori jofitimprurës ka pasur mbështetje më të rrallë në krahasim me vitet e mëparshme, dhe shuma në vlerën e donacioneve pothuajse është përgjysmuar krahasuar me një vit më parë. Kjo përqindje e reduktuar është shkaktuar nga rritja e përqindjes së donacioneve ndaj pushteteve lokale/kombëtare së bashku me individët dhe familjet.

Donacionet për lehtësimin e Kovid-19 gjeneruan shumicën e rasteve të dhurimit ndaj qeverive lokale dhe kombëtare, mbi gjysmën e rasteve të dhurimit ndaj institucioneve, pak më pak se një të tretën e rasteve të dhurimit ndaj individëve dhe familjeve dhe më shumë se një të katërtën e rasteve të dhurimit për organizatat jofitimprurëse.



Rastet e dhurimit(%)



Dhurimi i përgjithshëm



Rastet e dhurimit (%)



Organizatat jofitimprurëse si pranues

Gjatë vitit të pandemisë, 12.6% e të gjitha rasteve të dhurimit dhe 24.0% e shumës së dhuruar u orientuan drejt organizatave jofitimprurëse¹. Nëse marrim parasysh vetëm donacionet që nuk kanë të bëjnë me Kovid-19, mund të vërejmë një shpeshtësi më e lartë të dhurimit ndaj organizatave jofitimprurëse (18.0%). Nëse marrim parasysh donacionet vetëm për lehtësimin e Kovid-19, sektori jofitimprurës kishte një peshë prej më shumë se një të katërtën e shumës së dhuruar, e cila erdhi si pasojë e fushatave të suksesshme dhe të vlefshme për shpërndarjen e maskave respiratore, pajisjeve mbrojtëse, mburojave të fytyrës etj. Pothuajse tre të katërtat e të gjitha rasteve të dhurimit drejtuar sektorit jofitimprurës u dhuruan përmes fushatave për mbledhjen e fondeve. Më shumë se një e treta e të gjitha rasteve të dhurimit për organizatat jofitimprurëse, si dhe një e treta e shumës ishte për mbështetjen e grupeve të marginalizuara: më së shpeshti në formën e shërbimeve sociale, si mbështetja e kuzhinave publike.

Qytetarët ishin donatorët më aktivë dhe bujarë për organizatat jofitimprurëse në dhurimin e përgjithshëm, dhe vetëm për aksionet në lidhje me Kovid-19. Nga numri total i rasteve të dhurimit të drejtuar për sektorin jofitimprurës, 40.0% ishin nga qytetarët. Individë të caktuar morën pjesë në më shumë se një të katërtën e rasteve të dhurimit për organizatat jofitimprurëse, ndërsa pesha e dhurimit individual në aksione që nuk kanë të bëjnë me Kovid-19 ishte më e lartë - më shumë se një e treta e të gjitha aksioneve. Është e rëndësishme të theksohet se shumica e donacioneve individuale për organizatat jofitimprurëse ishin nga donatorët e diasporës. Gjatë vitit të pandemisë, donacionet e sektorit të korporatave gjeneruan 40.0% të rasteve të dhurimit që kanë të bëjnë me Kovid-19, kryesisht në formë të ushqimeve dhe materialeve mjekësore.



Rreth tre të katërtat e rasteve të dhurimit ndaj sektorit jofitimprurës iu drejtuan shoqatave vendase. Nga dhurimi i përgjithshëm për shoqatat vendore, më pak se tre të katërtat e shumës së dhuruar i janë drejtuar dy organizatave: Shoqatës Jetimët e Ballkanit dhe Kryqit të Kuq të Kosovës. Nëse marrim parasysh fondacionet private, më të mbështeturat në vitin 2020 ishin Fondacioni Labinot Tahiri dhe Fondacioni Golden Eagle.

¹ Kur mbledhim të dhëna për sektorin jofitimprurës, ne monitorojmë shoqatat vendase, shoqatat huaja, organizatat si agjencitë e OKB-së dhe fondacionet private.



Ngjashëm me vendet e tjera të rajonit, sektori jofitimprurës në Kosovë është përkrahur më rrallë se në vitin paraprak. Gjithashtu, pesha në vlerën e donacioneve është pothuajse përgjysmuar krahasuar me një vit më parë. Kjo përqindje e reduktuar ka shumë të gjasa të jetë shkaktuar nga shumë fushata online që janë organizuar nga individë dhe grupe joformale. Kjo bëri që njerëzit të dhurojnë drejtpërdrejt për individët dhe familjet së bashku me qeveritë kombëtare dhe lokale.

Profili i donatorëve për organizatat jofitimprurëse si pranues

Rastet e dhurimit(%)





Dhurimi i përgjithshëm



Profili i donatorëve për organizatat jofitimprurëse si pranues

Rastet e dhurimit(%)



Shoqata Jetimët e Ballkanit mbledhi fonde për familjet në nevojë ekonomike

Siç e kemi regjistruar, në vitin 2020 **Shoqata Jetimat e Ballkanit** ka mbledhur mbi 1,000,000 euro për shtëpi të reja për familjet në nevojë ekonomike në të gjitha komunat e Kosovës. Përmes platformës për mbledhjen e fondeve GoFundMe shoqata mbledhi rreth 650,000 euro nga donatorët vendas dhe diaspora për ndërtimin e Shtëpisë për të Moshuar në Suharekë, pako ushqimore, ndihmë mujore për jetimët, shtëpi dhe banesa për familjet në nevojë, ndihmë për pacientët e sëmurë dhe shujta humanitare.

Fondacioni Golden Eagle dhe Frutex filluan fushatën “1 cent për bamirësi”

Fondacioni **Golden Eagle** dhe **Frutex** iniciuan fushatën “1 cent për bamirësi” për mbështetjen e familjeve që jetojnë në kushte sfiduese socio-ekonomike. Gjatë fushatës, për çdo produkt “Relax” të shitur, një cent shkonte për fushatën. Janë mbledhur gjithsej 132,000 euro, të cilat janë destinuar për ndërtimin e shtëpive për familjet dhe njerëzit që jetojnë në kushte sfiduese socio-ekonomike, shpërndarjen e pakove ushqimore, si dhe për trajtime mjekësore për personat me probleme shëndetësore dhe për mbështetjen e stafit mjekësor në qendrat shëndetësore në mbarë Kosovën.

Aksioni për nëna dhe fëmijë mbështeti institucionet shëndetësore

Shoqata Aksioni për nëna dhe fëmijë inicioi fushatën humanitare “Një Kafe si Flutur” e cila kishte dy synime kryesore: mbledhjen e fondeve për blerjen e pajisjeve të nevojshme mjekësore për institucionet shëndetësore dhe sensibilizimin me këshilla nga burime të besueshme për qytetarët se si të ndalojnë përhapjen e koronavirusit. Fondet u mbledhën përmes platformës GlobalGiving me transferta bankare dhe donacione përmes SMS (një SMS vlente një euro). Shuma totale e mbledhur përmes iniciativës ishte 10,000 euro, të cilat ishin të destinuara për blerjen e pajisjeve dhe materialeve mbrojtëse për Klinikën Infektive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë. Pajisjet e dhuruara përfshinin monitor të pacientit, pulsoksimetër, respirator, dezinfektues, doreza mbrojtëse etj.

Fushata humanitare “Barazo faturën” për SOS Fshatrat e Fëmijëve

Për të gjashtën herë me radhë **Meridian Express, SOS Fshatrat e Fëmijëve** dhe një rrjet i dyqanesh të lagjeve në Kosovë organizuan fushatën “Barazo Faturën”. Gjatë muajit të Ramazanit, në kuadër të fushatës, të gjithë klientët e Meridian Express patën mundësinë të dhurojnë duke rrumbullakësuar faturën e tyre. Shuma totale e mbledhur ishte 6,000 euro, të cilat ishin të destinuara për mbështetjen e SOS Fshatrave të Fëmijëve.

Shteti si pranues

Gjatë vitit 2020, 42.8% e rasteve të dhurimit dhe 37.6% e shumës i janë drejtuar shtetit (institucioneve dhe pushteteve lokale/kombëtare). Në Kosovë, qeveritë lokale dhe kombëtare kishin rol të spikatur në luftën kundër Kovid-19, shpesh duke vepruar si ndërmjetës mes institucioneve. Fondi kombëtar për menaxhimin e Kovid-19 ishte pika kryesore e përpjekjeve të ofruara nga qeveria gjatë pandemisë. Kjo korrespondon me faktin se nga të gjitha rastet e dhurimit që kanë të bëjnë me Kovid-19, pothuajse gjysmat iu drejtuan qeverive lokale dhe kombëtare. Vetëm 17.8% e rasteve të dhurimit që përfshijnë 2.6% të shumave që kanë të bëjnë me Kovid-19 iu dhuruan drejtpërdrejt institucioneve. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se shumica e donacioneve për institucionet shëndetësore në Kosovë kanë kaluar përmes punës së qeverive lokale dhe kombëtare.


Edhe pse mendohej se shumica e përpjekjeve të drejtuara drejt institucioneve shëndetësore ishin për lehtësimin e Kovid-19, ne kemi regjistruar një bilanc të dhurimit për segmentet e tjera të kujdesit shëndetësor, veçanërisht në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Rreth gjysma e shumës ishte dedikuar për kujdesin shëndetësor (shumica e saj për investime kapitale dhe pajisje që iu dhuruan seksioneve dhe klinikave gjinekologjike, të pediatriisë dhe onkologjisë në mbarë Kosovën). Për shembull, nga të gjitha pajisjet e dhuruara për shtetin, 38.2% e rasteve nuk kishin të bëjnë me Kovid-19. Këto pajisje përfshinin sisteme me ultratinguj, pajisje për një Klinikë Onkologjike dhe pajisje për Klinikën e Pediatriisë (një matës pulsi, një makinë infuzioni dhe pajisje lidhur me kardiotokografinë).

Sa i përket kategorive të donatorëve, sektori i korporatave ishte donatori më aktiv për shtetin në dhurimin total, si dhe në mbështetjen lidhur me Kovid-19: diku më pak se gjysma e të gjitha rasteve të dhurimit për Kovid-19. Megjithatë, pjesa më e madhe e shumës së dhuruar për shtetin është mbledhur nga qytetarët (më shumë se gjysma e shumës). Qytetarët ishin donatorët më bujarë edhe në dhurimin që ka të bëjë vetëm me Kovid-19, duke marrë pjesë në 40.9% të shumës së dhuruar.


Profili i donatorëve për Shtetin si pranues

Rastet e dhurimit (%)

- **43.0%** Sektori i korporatave
- **32.9%** Indivdët
- **9.3%** Shumica individuale
- **7.2%** Fondacione private
- **5.9%** OSHC / Shoqatat
- **1.7%** Të tjera





Dhurimi i përgjithshëm



- Kovid-19
- Dhurimi që nuk ka të bëjë me Kovid-19

Profili i donatorëve për Shtetin si pranues

Rastet e dhurimit (%)



Shoqata “Jeta Vita” dhe kompania Swissmed Kosova dhuruan një pajisje mjekësore

Pranë **Swissmed Kosova, Shoqata “Jeta Vita”** i dhuroi Institutit të Patologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës edhe një analizator automatik në vlerë prej rreth 80,000 euro. Falë këtij kontributi, metoda ndihmëse për diagnostikimin e kancerit të gjirit do të jetë e disponueshme për herë të parë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, duke mundësuar trajtimin në përputhje me protokollet e fundit.

NLB Bank i dhuroi Qendrës Klinike Universitare pajisje mjekësore dhe ilaçe

NLB Bank i ofroi pajisje mjekësore dhe ilaçe Qendrës Klinike Universitare të Kosovës në vlerë të përgjithshme prej 20,000 euro. Pajisjet e dhuruara përfshinin dy mikroskopë trinokularë, të destinuar për Klinikën e Pediatriisë dhe Repartin e Hematologjisë, të cilët u dorëzuan në dhjetor të vitit 2020, ndërsa pajisjet e tjera mjekësore ishin të destinuara për Klinikën e Anestezio-logjisë, ku trajtoheshin pacientët me Kovid-19.

Elkos Group - ETC mbështeti edukimin online

Elkos Group - ETC u dhuroi nxënësve 460 laptopë të rinj në vlerë prej 100,000 euro. Laptopët janë dorëzuar më 4 maj në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe më pas janë paraparë të shpërndahen nëpër komunat në mbarë vendin.

ProCredit Bank mbështeti luftën kundër pandemisë

Si reagim ndaj pandemisë Kovid-19, **ProCredit Bank** i dhuroi materiale dhe pajisje mbrojtëse Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Pajisjet e dhuruara, me vlerë prej 25,000 euro, përfshinin maska, doreza, dezinfektues, termometra etj.

Profesori krijoi një prototip të një maske mbrojtëse për fytyrën për punonjësit e mjekësisë

Dr. Shaban Buza, profesor në Universitetin e Prishtinës, bëri një prototip të maskës mbrojtëse të fytyrës për personelin mjekësor në vijë të parë të luftës kundër pandemisë. Maska u krijua nga një printer 3D dhe bazohet në një model që vjen si rezultat nga një bashkëpunim midis Universitetit të Transilvanisë në Rumani dhe Universitetit Politeknik të Valencias në Spanjë. Donatorët e mbështetjen nismën duke dhuruar fonde për materialin dhe printerët 3D. Dyzet maska i janë dhuruar Komunës së Ferizajt, pesëdhjetë maska i janë dhuruar komunës së Prishtinës, ndërsa Qendra Klinike Universitare e Kosovës ka pranuar 140 maska, të gjitha më pas i janë shpërndarë personelit shëndetësor.

Vullnetarët e Universitetit të Prishtinës ndihmuan në institucionet shëndetësore

Fakulteti i Mjekësisë inicioi një thirrje për ndihmë gjatë pandemisë në qendrat shëndetësore në Kosovë. Thirrjes iu përgjigjën mbi 300 vullnetarë, mes të cilëve mjekë, infermierë, punonjës socialë, psikologë, studentë të Fakultetit të Mjekësisë e të tjerë. Vullnetarët asistuan në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, Klinikën Infektive, Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucione të tjera shëndetësore. Universiteti i Prishtinës hapi edhe një qendër thirrjesh, e cila ofronte informacionet e nevojshme për qytetarët gjatë pandemisë Kovid-19, 24 orë në ditë.



Përfituesit përfundimtarë

Në vitin e pandemisë, njerëzit në nevojë ekonomike ishin përfituesit më të mbështetur, si në shpeshësinë e mbështetjes ashtu edhe në vlerën e dhuruar. Më saktësisht, 28.8% e shumës së dhuruar përmes 41.5% të të gjitha rasteve të dhurimit është drejtuar për njerëzit në nevojë ekonomike. Nëse marrim parasysh vetëm donacionet për lehtësimin e Kovid-19, pak më pak se gjysma e rasteve të dhurimit u drejtuan ndaj këtij përfituesi.



Popullsia nga komunitetet lokale kishte një përqindje prej pak më pak se një të tretën e të gjitha rasteve të dhurimit, nga të cilat rreth gjysma ishin destinuar për qëllimin e zbutjes së efekteve negative të Kovid-19. Njerëzit me probleme shëndetësore kishin një pjesëmarrje prej rreth një të katërtën e shumës totale të dhuruar. Nëse marrim parasysh donacionet që nuk kanë të bëjnë me Kovid-19, mbështetja e donatorëve ndaj njerëzve me probleme shëndetësore ishte më e lartë - pothuajse një e treta e vlerës së dhuruar.

Njerëzit me aftësi të kufizuara kishin një pjesëmarrje prej 8.4% në totalin e shumës së dhuruar, e cila është disi më e lartë në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Kjo mbështetje kryesisht përfshinte dhurimin e mjeteve ndihmëse nga shoqata e diasporës Fehmi Agani nga Arendali i Norvegjisë. Përveç përfituesve kryesorë, një përqindje relativisht e lartë e shumës së dhuruar në lidhje me pandeminë iu drejtua popullatës së përgjithshme: 27.8%. Në dhurimin që nuk kishte të bëjë me pandeminë, të moshuarit kishin një pjesëmarrje prej 2.5% të rasteve të dhurimit dhe 11.4% të vlerës së dhuruar. Numri më i madh i donacioneve që nuk kishin të bëjnë me Kovid-19 është rezultat i fushatës së Shoqatës Jetimët Ballkanit të fokusuar në ndërtimin e shtëpisë për të moshuarit.


Rastet e dhurimit (%)



Dhurimi i përgjithshëm



Rastet e dhurimit(%)



Të tjerë: Rastet e dhurimit (%)

	Dhurimi i përgjithshëm	Kovid-19	Dhurimi që nuk ka të bëjë me Kovid-19
5-10%	-	popullsia e përgjithshme	njerëz që jetojnë në shtete tjera
3-5%	popullsia e përgjithshme	-	fëmijë pa përkujdesje prindërore
1-3%	njerëz që jetojnë në shtete tjera, fëmijë pa përkujdesje prindërore, të moshuarit	fëmijë pa përkujdesje prindërore, njerëz që jetojnë në shtete tjera	të moshuarit, prindër vetushqyes, bashkësitë fetare, të mbijetuarit e dhunës, të pastrehët
0-1%	prindër vetushqyes, bashkësitë fetare, të pastrehët, gra dhe fëmijë të mbijetuar nga dhuna, nëna dhe të porsalindur, komunitete pakicë, fëmijë dhe të rinj të talentuar, përfitues të përzier	komunitete pakicë, të moshuarit	popullsia e përgjithshme, nëna dhe të porsalindur, fëmijë dhe të rinj të talentuar, përfitues të përzier

Raiffeisen Bank Kosovë dhuroi tabletë dhe mjete shkollore

Raiffeisen Bank Kosovë shpërndau 151 tabletë dhe 275 çanta shkollore me mjete për Drejtorinë Komunale të Arsimit në Prizren të destinuar për t'u shpërndarë për fëmijët e familjeve me status të pa favorshëm social. Ky kontribut është bërë si pjesë e organizatës bamirëse Herbert Stepic CEE, në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet UNICEF-it dhe Raiffeisen Bank në Kosovë. Qëllimi ishte rritja e bashkëpunimit në promovimin e çështjeve me rëndësi sociale dhe kujdesit ndaj fëmijëve. Pajisjet dhe mjetet e dhuruara, në vlerë prej mbi 30,000 euro, iu shpërndanë nxënësve të shkollave: "Lidhja e Prizrenit", "Motrat Qiriazit" dhe "Remzi Ademaj".

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile mbështeti Platformën për Personat me Aftësi të Kufizuara

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile mbështeti Forumin Kosovar për Aftësinë e Kufizuar - FKAK për të ndihmuar në krijimin e një platforme online për personat me aftësi të kufizuara. Buxheti i këtij projekti ishte 4,900 euro dhe u zbatua nga 1 shtatori deri më 31 dhjetor të vitit 2020. Përmes kësaj platforme personat me aftësi të kufizuara nga Kosova mund të gjenin të gjitha informacionet që u nevojiteshin se si mund të ndikojë kriza nga Kovid-19 tek ato. Platforma ofroi informacion mbi regjistrimin për shërbimet për fëmijët me aftësi të kufizuara në rast izolimi (shërbime psikologjike, rehabilituese, sociale), si të mbrohem nga virusi, një listë ekspertësh që mund të ofrojnë shërbime dhe informacione shtesë të përditësuara përkatëse.

Fushata DashnieKujdes përmirëson shëndetin e nënave dhe fëmijëve në Kosovë

Në bashkëpunim me **Aksionin për nëna dhe dhe fëmijë, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)** filloi fushatën "DASHNIEKUJDES" ("LoveAndCare") për përmirësimin e shëndetit të nënave dhe fëmijëve në Kosovë dhe ndërgjegjësimin për të ndaluar stigmën e njerëzve të prekur nga Kovid-19. Qytetarët mund të bëheshin pjesë e fushatës duke postuar #dashniekujdes, #loveandcare dhe #ljubavipažnja. Mjetet u mbledhën përmes donacioneve me SMS, thirrjeve në numrin humanitar të fondacionit, donacioneve online dhe sponsorizimeve nga donatorët.

Efektet e dhurimit

Nëse marrim parasysh efektet e dhurimit, ne i ndajmë donacionet bazuar në llojin e mbështetjes që ato ofrojnë. Në këtë kuptim, donacionet mund të ofrojnë mbështetje afatgjatë² (strategjike) ose mbështetje të njëhershme (afatshkurtër). Konkretisht, mbështetja afatshkurtër synon të ofrojë përfitime për individë të caktuar, ose grupe individësh, për një kauzë specifike, ndërsa mbështetja afatgjatë synon të krijojë një ndikim pozitiv për një mori përfituesish. Më shumë se dy të tretat e të gjitha rasteve të dhurimit në vitin 2020 ishin donacione të njëhershme, ndërsa dhurimi strategjik mori pjesë në më shumë se një të katërtën e të gjitha rasteve të dhurimit.

Mbështetja strategjike ishte kryesisht në formën e pajisjeve të tilla si tunele dezinfektuese, pajisje oksigjeni dhe pajisje të tjera mjekësore. Sa i përket vetëm dhurimit që nuk ka të bëjë me Kovid-19, mbështetja strategjike gjeneroi pothuajse tre të katërtat e shumës. Më shumë se një e treta e kësaj shume është gjeneruar përmes donacioneve në formën e pajisjeve si laptopë dhe mjete të tjera edukative si dhe pajisje ndihmëse. Sa i përket vlerës së donacioneve, mbështetja strategjike kishte një peshë pak më të madhe se sa mbështetja e njëhershme. Kjo për shkak të donacioneve në formën e pajisjeve të vlefshme, investimeve në infrastrukturën publike dhe bursave.



Vetëm për donacionet që kanë të bëjnë me Kovid-19, pjesa më e madhe e shumës është gjeneruar nga donacionet e njëhershme (kryesisht mbështetje humanitare dhe sigurimi i të mirave dhe materialeve të konsumit), që është specifike për Kosovën në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Në krahasim me një vit më parë, mbështetja strategjike ka pasur një rënie në shpeshësinë e mbështetjes (43.7% në vitin 2019). Sqarimi për këtë është rritja e dhurimit të njëhershëm, për shkak të aksioneve të shumta për shpërndarjen e të mirave dhe materialeve të konsumit si ushqime dhe pako për familjet me status të pa favorshëm social.

² Investimet afatgjata (mbështetja strategjike) përfshijnë investime kapitale, pajisje, shërbime, bursa (investimi në personel), hulumtim dhe zhvillim, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit social. Rastet e dhurimit afatshkurtër përfshijnë mbështetjen humanitare, dhurimin sezonal, trajtimet mjekësore për individët/familjet dhe të mirat dhe materialet e konsumit. Qëllimi i dhurimit nuk mund të përcaktohet gjithmonë. Për shembull, të dhënat e disponueshme mund të tregojnë se i është ofruar mbështetje një institucioni/organizate të caktuar, por nuk tregojnë se për çfarë është ofruar ajo mbështetje.

Përdorimi i rasteve të dhuirmit (%)



- **69.5%** Mbështetje e njëhershme
- **28.2%** Mbështetje afatgjatë
- **2.3%** Të panjohura

Dhurimi i përgjithshëm



- Kovid-19
- Dhurimi që nuk ka të bëjë me Kovid-19

Përdorimi i rasteve të dhurimit (%)



IPKO i dhuroi një pajisje mjekësore Qendrës Klinike Universitare

Kompania me përgjegjësi shoqërore **IPKO** ka vite që përkrah nisma të ndryshme që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor. Në vitin 2020, kompania i ka dhuroi Klinikës së Onkologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës një aparaturë në vlerë prej 15,000 eurosh që diagnostikon sëmundjet malinje. Kjo pajisje e sofistikuar me ultratinguj, Philips ClearValue 650, mund të zbulojë kancerin në fazat e tij të hershme. Ky kontribut do të ndihmojë në përmirësimin e kapaciteteve dhe cilësisë së trajtimit të ofruar nga Klinika e Onkologjisë, në të cilën kryhen 12,000 ekzaminime çdo vit.

Aplikimi online për leje ndërtimi në Prishtinë

Universiteti i Biznesit dhe Teknologjisë (UBT) krijoi dhe i dhuroi Komunës së Prishtinës një sistem të quajtur "Aplikacioni online për leje ndërtimi", e cila është komuna e parë që lansoi këtë sistem në Kosovë. Aplikacioni digjitalizon procedurën e lejeve të ndërtimit dhe procesin e trajtimit të kërkesave drejtuar ndaj Drejtorisë së Urbanizmit. Ky sistem online do të ndihmojë në përsheptimin e procesit të aplikimit, rritjen e transparencës, uljen e kostove dhe ruajtjen e mjedisit. Zbatimi i aplikacionit ishte në faza dhe i disponueshëm për përdorim që nga data 12 tetor në vitin 2020.

Faqja e re zyrtare e Teatrit Dodona

Teatri Dodona përfitoi webfaqen e tyre të re zyrtare që përdor një sistem elektronik për rezervimin e biletave. Nën patronazhin e këngëtares **Dua Lipa, Fondacioni Sunny Hill** dhuroi këtë webfaqe, e cila kishte vlerën prej 5,000 eurove.

Fushata "I Love You All" u ofroi maska punonjësve të trafikut urban

Studentët dhe stafi i fakultetit të artit dhe mediave digjitale në **Universitetin për Biznes dhe Teknologji** iniciuan fushatën „I Love You All”. Përmes kësaj fushate, punëtorëve të trafikut urban në Prishtinë gjatë pandemisë iu dhuruan maska. Me mbështetjen e universitetit, këto maska inovative janë dizajnuar dhe krijuar nga studentët e Fakultetit të Dizajnit të Integruar dhe Arbnor Demaj.

Përfshirja mediatike e dhurimit

Media ndikon ndjeshëm në zhvillimin e filantropisë duke luajtur një rol përcaktues të agjendës, duke përcaktuar përmbajtjen ndaj të cilës jemi të ekspozuar dhe thjerrëzat përmes të cilave interpretojmë këtë përmbajtje. Në vitin 2020, 1,189 raporte mediatike kanë përfshirë aksionet filantropike në Kosovë.

Shumica e këtyre raporteve mediatike ishin përmes mediave online (webfaqeve dhe portaleve), ndërsa një pjesë më e vogël përmes mediave elektronike dhe mediave të shkruara. Megjithatë, 70.8% e raporteve të mediave elektronike mbi filantropinë kanë ndodhur gjatë kohës të parë. Mediat online që ofrouan përfshirje më të madhe ishin botasot.info, telegrafi.com dhe ekonomiaonline.com. Mediat elektronike që ishin më aktive në raportimin e filantropisë ishin **RTK-Radio Televizioni i Kosovës, gazetametro.net** dhe **Kohavision**. Mediat e shkruara përbëheshin nga vetëm 2.4% të raporteve, me gazetatat më aktive që ishin **Vesti—Frankfurt, Večernje Novosti** dhe **Epoka e Re**.

Është e rëndësishme të theksohet se 100% e këtyre raporteve mediatike ishin pozitive. Kjo u mundëson aktorëve filantropikë të arrijnë një audiencë të gjerë donatorësh të mundshëm që vijnë nga një gamë e gjerë profilesh demografike, interesa të dhurimit dhe zona gjeografike.

Raportet e mediave



Përfshirja mediatike


Raportet (%)

71.0% Media kombëtare

26.1% Rajonale (Ballkani Perëndimor)

2.8% Media nën-rajonale

0.1% Lokale




Kategoria e medias

Reportet (%)

93.6% Media Online

4.0% Media elektronike (radio dhe TV)

2.4% Media e shkruar



Përmbledhje e metodologjisë

Ky raport është përgatitur duke përdorur bazën e të dhënave Giving Balkans, e cila mbetet baza e të dhënave më e besueshme për dhurimin filantropik në rajon. Për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare (p.sh., Ministrinë e Financave ose Administrata Tatimore), Catalyst Balkans përdor mënyra alternative për të mbledhur të dhëna, kryesisht përmes raporteve mediatike dhe burimeve të tjera të disponueshme si raportet e donatorëve dhe pranuesve. Gjatë vitit 2020, raportet e mediave janë grumbulluar duke monitoruar mediat e shkruara, elektronike dhe online në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar në Kosovë nga 1 janari i vitit 2020 deri më 31 dhjetor të vitit 2020. Në këtë periudhë, bazën e të dhënave Giving Balkans janë përpunuar gjithsej 1,189 raste që kanë të bëjnë me dhënien e bamirësisë nga të gjitha kategoritë e donatorëve në, nga të cilat 554 ishin raste unike.

Kjo metodologji ka kufizime, duke përfshirë faktin më të rëndësishëm që media nuk i regjistron të gjitha dhurimet filantropike. Megjithatë, ne besojmë se hulumtimi ynë ofron një pasqyrë mjaft të besueshme në aspektet thelbësore të dhurimit filantropik, sepse shifrat, edhe pse jo gjithëpërfshirëse, ofrojnë një vlerë minimale për treguesit përkatës. Nëse, për shembull, diskutojmë për numrin e rasteve të dhurimit filantropik mund të themi me siguri se numri që ne tregojmë është numri minimal i rasteve që kanë ndodhur. E njëjta gjë është e vlefshme për shumat, aktorët dhe të ngjashme. Prandaj, këto të dhëna mund të përdoren si tregues të shkallës minimale të zhvillimit të filantropisë në Kosovë.

Ne zakonisht paraqesim trendet në zhvillimin e dhurimit pa vlera të jashtëzakonshme (d.m.th., fatkeqësitë ose donacionet e njëhershme, të cilat tejkalojnë një pjesë të konsiderueshme të shumës së përgjithshme të regjistruar dhe nuk përsëriten), sepse këto veti të dhënash nuk janë përfaqësuese të dhurimit që përsëritet nga aktorët lokal çdo vit. Prandaj, kjo duhet të paraqitet veçmas. Për shkak të ndikimit që pandemia e Kovid-19 pati në dhurimin gjatë vitit 2020, ne vëzhguam të gjitha dimensionet që lidhen me filantropinë duke konsideruar veçmas dhurimin që ka të bëjë me Kovid-19 dhe dhurimin që ka të bëjë me të gjitha qëllimet e tjera. Në shtojcën e përfundimeve kryesore të raportit, ne gjurmiam dhe analiziam totalin vjetor të dhurimit të afateve kohore që nuk kanë të bëjnë me Kovid-19 për të ruajtur krahasueshmërinë e përgjithshme të të dhënave të vitit 2020 me të dhënat e marra në vitet e mëparshme.

Shtojcë – Trende krahasuese të dhurimit që nuk ka të bëjë me Kovid-19

Dhurimi i përgjithshëm

	2016	2017	2018	2019	2020
Shumat (€)	1,813,818.3	2,889,312.8	1,412,660.6	2,409,808.0	5,719,025.8
Numri i rasteve të dhurimit	512	600	344	229	278

Trendi në rritje i vlerës së regjistruar ka vazhduar, duke arritur një shumë prej dy herë më të lartë se një vit më parë.

Donatorët

Rastet e dhurimit (%)	2018		2019		2020
Shumica individuale	31.4%	↓	28.8%	↓	22.7%
Spektori i korporatave	18.0%	↓	11.8%	↑	13.3%
Individët	32.6%	↑	45.0%	~	46.0%

Shumat (%)	2018		2019		2020
Shumica individuale	49.7%	↓	40.9%	↑	42.9%
Spektori i korporatave	8.5%	~	7.6%	↓	3.7%
Individët	5.6%	↑	17.4%	↓	4.3%

Për sa i përket peshës së rasteve të dhurimit, trendi në rënie i dhurimit të shumicës individuale ka vazhduar, ndërkohë që nuk ka pasur trende të qarta për shumën e dhuruar.

Temat

Rastet e dhurimit (%)	2018		2019		2020
Shëndetësia	25.9%	↓	20.1%	↓	15.5%
Mbështetja e grupeve të marginalizuara	15.1%	↔	14.4%	↗	20.1%
Arsimi	21.8%	↗	30.6%	↓	23.0%
Lehtësimi i varfërisë	25.9%	↗	27.9%	↓	17.3%

Është vërejtur vazhdimësi e trendit rënës që nga viti më parë për kujdesin shëndetësor. Nga ana tjetër, mbështetja për grupet e marginalizuara ka pësuar një rritje të përqindjes së rasteve.

Pranuesit

Rastet e dhurimit (%)	2018		2019		2020
Individët/Familjet	57.8%	↗	69.0%	↓	59.7%
Organizatat jofitimprurëse	19.8%	↓	17.5%	↔	18.0%
Institucionet	17.4%	↓	13.1%	↔	13.7%
Qeveritë lokale/kombëtare	3.2%	↓	0.4%	↗	6.8%

Nëse marrim parasysh kategoritë e pranuesve, nuk u vërejtën trende të qarta. Në vitin e mëparshëm individët dhe familjet patën një rënie të pjesëmarrjes, ndërsa qeveritë lokale/kombëtare pësuan një rritje.

Përfituesit përfundimtar

Rastet e dhurimit (%)	2018		2019		2020
Komunitetet lokale	24.4%	↗	38.4%	↘	29.1%
Njerëz në nevojë ekonomike	30.8%	↔	30.6%	↗	33.8%
Njerëz me probleme shëndetësore	19.8%	↘	11.8%	↔	11.5%
Njerëz me aftësi të kufizuara	8.1%	↘	7.0%	↗	8.3%

Vërehet rënie e mbështetjes për popullatën nga komunitetet lokale, ndërsa njerëzit në nevojë ekonomike dhe njerëzit me aftësi të kufizuara kanë pësuar rritje.

Përdorimi i donacioneve

Përdorimi i donacioneve	2018		2019		2020
mbështetje e njëhershme	56.1%	↘	55.0%	↗	57.6%
mbështetje afatgjatë	35.5%	↗	43.7%	↘	38.8%
të panjohura	8.4%	↘	1.3%	↗	3.6%

Sa i përket efekteve të dhurimit, nuk u vërejt ndonjë trend i qartë. Pas një viti rënie, pjesëmarrja e dhurimit të njëhershëm është rritur, ndërsa pjesëmarrja e mbështetjes strategjike është zvogëluar.

Hulumtimi Kosova Dhuron 2020: Raporti vjetor mbi gjendjen e filantropisë është pjesë e një nisme më të gjerë për promovimin dhe stimulimin e filantropisë në rajon, e realizuar nga Fondacioni Catalyst. Hulumtimi themelor dhe ky botim u krijuan nga Fondacioni Catalyst (Catalyst Balkans) me mbështetjen bujare të Fondacionit C. S. Mott dhe Fondit Rockefeller Brothers.

Opinionet e shprehura në këtë botim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit C. S. Mott, Fondit Rockefeller Brothers, ose partnerëve të tyre.

Hulumtim i realizuar nga:



Hulumtim i mbështetur nga:





Catalyst Balkans

38 Takovska, 11000 Beograd, Serbia

catalystbalkans.org
givingbalkans.org

Dizajni

Dragana Pavloviq

Përgatitur nga

Milosh Antiq
Maja Gligoriq

Redaktuar nga

Aleksandra Vesiq
Vuk Vukoviq

Të dhëna të mbledhura nga

Adelina Ajdari Abdiu

Përkthimi

Adelina Ajdari Abdiu